



BASHKIA  
TIRANË  
REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK

VE N D I M

Nr. 124, datë 28.09.2020

“PËR

**MIRATIMIN E DHËNIES NË PËRDORIM TË AMBIENTEVE TË NDËRMARRJES  
OFIÇINA E AUTOMJETEVE TË TRANSPORTIT NDAJ QENDRËS KOMUNITARE  
“TË QËNDROJMË SË BASHKU” DHE ORGANIZATËS “NISMA PËR NDRYSHIM  
SHOQËROR - ARSIS”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “a” dhe pika 1/1.2, shkronja “a”, nenit 24, pikat 1 dhe 3, nenit 54, shkronja “e” dhe nenit 55, pikat 4 dhe 6 të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar; nenit 901 dhe në vijim të Ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar; Ligjit nr.9355, datë 10.03.2005, për “Ndhimën dhe Shërbimet Shoqërore” të ndryshuar; vendimit të Këshillit të Ministrave nr.143, datë 18.1.2012 “Për miratimin e listës paraprake (pjesa e parë+pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tiranë, të Qarkut të Tiranës”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 659, datë 17.10.2005, për “Standartet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale”, vendimit të këshillit bashkiak nr.87, datë 26.07.2017 në zbatim të projektit “Ngritja e shërbimeve për të mbrojtur fëmijët nga abuzimi, neglizhimi, dhuna dhe shfrytëzimi në Tiranë, nëpërmjet vënies në punë të qendrës multifunksionale në Njësinë Administrative nr.7”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 62, datë 10.11.2006, Për krijimin e Qendrës Sociale “Të qëndrojmë së bashku”, vendimit të këshillit bashkiak nr. 67, datë 12.06.2020 “Për riorganizimin e Qendrave Sociale të Bashkisë Tiranë, në Qendra Komunitare” si dhe vendimit të Këshillit Drejtues të Oficinës së Automjeteve Tiranë nr. 2 prot., datë 03.09.2020, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak:

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë dhënien në përdorim pa kundërshtim për një periudhë 1 (një) vjeçare, të ambienteve të Oficinës së Automjeteve, me sipërfaqe të trualli  $\text{Str}=1280.0 \text{ m}^2$  dhe sipërfaqe ndërtimi  $\text{Snd.} = 633.6 \text{ m}^2$ , ndaj Qendrës Komunitare “Të Qëndrojmë së bashku”, përkatësisht  $\text{Snd} = 352 \text{ m}^2$ , dhe Organizatës “Nismës për Ndryshim Shoqëror – ARSIS”, përkatësisht  $\text{Snd} = 281.6 \text{ m}^2$  (sipas planimetrisë bashkëngjitur).
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Qendra Komunitare “Të Qëndrojmë së bashku”, Organizata “Nisma për Ndryshim Shoqëror – ARSIS”, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Liçensimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale dhe Ndërmarrja Ofiçina e Automjeteve.

**3.**Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut, Tiranë.

**K R Y E T A R**

**TONI GOGU**